



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:019181

Datë: 05.08.2020

Numri i dokumentit: 01050041

**P. nr.100/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.K nga fshati ... Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.65/2020 të datës 25.02.2020, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur me datë 28.07.2020, në prani të Prokurorit të shtetit Enis Gashi dhe të akuzuarit N.K, me datë 30.07.2020 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 04.08.2020 përpiloi këtë :

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **N.K** nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, data e lindjes... në Gjakovë, i biri i K., dhe i P., e gjinisë D., i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. ID...

**Ë s h t ë f a j t o r :**

**Sepse:**

**-me datë 08.01.2020 në kohë të pacaktuar, në Gjakovë në rrugën "...",** pikërisht në parkingun prapa ndërtesave, afër objektit të Hidrosistemit "R", me qëllim që vetit apo tjetrit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, i merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit K.N nga Gjakova, në atë mënyrë që duke lëvizur me veturën e tij të tipit "Opel Kadet", ngjyrë e bardhë, me targa ..., në parkingun prapa ndërtesave, vëren veturën e tipit "Opel Kadet", ngjyrë vishnje me targa ..., pronë e të dëmtuarit K.N, e cila ishte parkuar në vendin e lartcekur, e cila ishte e njëjtë me veturën e tij dhe me forcë duke përdorur çelësin e rrotave, i merr nga vetura e të dëmtuarit dy gommat e anës së majtë si dhe gomën rezervë nga bagazhi i veturës, në vlerë rreth 100 euro dhe nga aty largohet në drejtim të panjohur, ndërsa të nesërmen i vendos gommat e vjedhura në veturën e tij.

**-me çka ka kryer veprë penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar. 1.1 të KPRK-së**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39,43, 46, 47, 48, 49 par.5,69, 70, 71, 72 të KPRK-së, dhe nenit 315 par.1 nënpar. 1.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit Nikë Krasniqi, i shqipton:

**DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe dënimin me gjobë në shume prej **200 (dyqind) euro**, të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund te ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 43 të KPRK-së ,atëherë i njëjti iu zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **10(dhjetë ) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shumën prej 30,00 € si dhe në emër te paushallit gjyqësor shumën prej 20,00 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.65/2020 të datës 25.02.2020, ka akuzuar të akuzuarin N.K nga fshati ...Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 28.07.2020 përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Prokurori i Shtetit Enis Gashi, lexoi aktakuzën PP/II.nr.65/2020 të datës 25.02.2020, me ç ‘rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës me përmirësimin e të dhënave personale si në procesverbal.

I akuzuari N.K, gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës duke i ditur edhe më parë pasojat dhe favoret juridike të pranimit të fajësisë, dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion. Shtoi se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam pënduar për veprën e kryer, kërkoj falje nga i dëmtuari për veprimet e mia, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimi i shprehur në gjykatë për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe nuk do të përsërisë ndonjë vepër tjetër penale, gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, të më shqiptojë një dënim më të butë.

I dëmtuari K.N, përmes telefonit me nr.044-.... , ka njoftuar gjykatën për pamundësinë e ardhjes në gjykatë dhe i njëjti ka deklaruar se gomat janë kthyer në Stacionin Policor në Gjakovë, andaj ndaj të akuzuarit nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi.

Duke u deklaruar lidhur me fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurori i shtetit Enis Gashi ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimit te fajësisë, nga vet pranimi i fajësisë është vërtetuar ne tërësi gjendja e plote dhe e drejtë faktike si ne dispozitivin e aktakuzës.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari N.K. : **me datë 08.01.2020, në kohë të pacaktuar, në Gjakovë në rrugën “...”**, pikërisht në parkingun prapa ndërtesave, afër objektit të Hidrosistemit “R”, me qëllim që vetit apo tjetrit t’i sjellë përfitim pasuror te kundërligjshëm, i merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit K.N nga Gjakova, në atë mënyrë që duke lëvizur me veturën e tij të tipit “Opel Kadet”, ngjyrë e bardhë, me targa ..., në parkingun prapa ndërtesave, vëren veturën e tipit “Opel Kadet”, ngjyrë vishnje me targa ..., pronë e të dëmtuarit K.N, e cila ishte parkuar në vendin e lartcekur, e cila ishte e njëjtë me veturën e tij dhe me forcë duke përdorur çelësin e rrotave, i merr nga vetura e të dëmtuarit dy gomat e anës së majtë si dhe gomën rezervë nga bagazhi i veturës, në vlerë rreth 100 euro dhe nga aty largohet në drejtim të panjohur, ndërsa të nesërmen i vendos gomat e vjedhura në veturën e tij.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin kundër të akuzuarit dhe llojit të tij, Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës, pendimin e tij, premtimin e tij se nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme, kërkim falja publike në gjykatë nga i dëmtuari, sjelljen korrekte në gjykim, gjendjen e dobët ekonomike, deklarin e të dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar nga ana e gjykatës, të cilat rrethana ndikuan që gjykata duke pasur parasysh edhe mënyrë e kryerjes së kësaj vepre penale, rrezikshmërinë e saj, ka zbatuar dispozitat e zbutjes së dënimit bazuar në nenin 72 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin nën minimumin e përcaktuar ligjor dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1(një) viti** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin **prej 2(dy) viteve**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe **dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro**, me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesë pasurore juridike, ngase i dëmtuari K.N, gjatë shqyrtimit fillestar nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë prej 20,00 € ,në emër të paushallit gjyqësor është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.100/20 më datë 30.07.2020.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.